

# Varietetet e dredhëzës!

HERSHME



**Clery (PVR)** - Varietet shumë i hershëm, tejet i përshtatshëm për klimën tonë. Një nga varietetet më të përhapura në Evropë. Kombinim ekselent mes produktivitetit dhe shijës. Ka frut të madh dhe falë formës së rregulltë dhe shkëlqimit të frutit, është varietet me potencial për tregun e freskët. Ka zëvendësuar me sukses varietetin **Alba**.



**Aprica (PVR)** - Varietet i ri italian. Varietet shumë i hershëm. Frutat janë të mëdhenj me shkëlqim të kuq, në formë konike. Karakterizohet me përqindje të lartë të frutave të klasit të parë. është ekuivalent i Albes. Me qëndrueshmërinë e saj të jashtëzakonshme pas vjeljes, Aprica rekomandohet si një varietet për tregun e freskët.

MESME



**Joly (PVR)** - Varietet me kohë të pjekjes mesatare (Clery +5). I përshtatshëm për tokat me më pak vlera ushqyese. I nevojitet më pak ushqime në krahasim me varietetet të tjera. Ka produktivitet të lartë dhe kohë të gjatë të vjeljes. Lulja është shumë e madhe dhe e pasur me polen. Fruti ka formë konike me ngjyrë të qelët.

VONSHME



**Arosa (PVR)** - Varietet me pjekje të vonshme. I përshtatshëm për klimën kontinentale. Më i rezistueshëm ndaj ngricave. Formë konike dhe ngjyrë më të qelët të frutit. Karakterizohet me prodhimtari të lartë.

INDUSTRIALE



**Senga Sengana (PVR)** - Varietet tejet i përhapur dhe në përdorim që nga vitet e 50-ta. është ideal për industrinë e ngrirjes dhe përpunimit, pasi ka shije të ëmbël dhe ruan atë gjatë ngrirjes. Ka ngjyrë më të mbyllur. Karakterizohet me prodhimtari të lartë, është rezistent ndaj thatësirave dhe ngricave. Jetëgjatësia e frutit është e vogël.

MUJORE



**Murano (PVR)** - Varietet me frutëdhënie mujore. Tejet i përshtatshëm për tregun e freskët, në saje të qëndrueshmërisë së frutit dhe jetëgjatësisë së gjatë pas vjeljes. Karakterizohet me prodhim të lartë dhe kohëzgjatje të madhe të vjeljes, deri para ngricave të para. Shije të ëmbël në saje të nivelit të lartë të Brix-it.

